

Mbi të vërtetën në retorikë - Një parashtrim përmes shqyrtimit të pikëpamjeve të Gorgiasit në optikën filozofike të Sokratit

*Hajdin Abazi**

Hyrje

Objekti i kësaj trajtëse është shqyrtimi midis pikëpamjeve të Gorgiasit dhe Sokratit mbi retorikën. Përmes qasjes krahasuese dhe interpretuese, synohet të parashtrohen pikëpamje të ndryshme, për të arritur në një përfundim mbi të vërtetën në retorikë.

Ky objektiv duket si një pikësypnim i lehtë i arritshëm, por nuk është aspak kështu. Për ta kuptuar se sa e komplikuar është çështja e së vërtetës në retorikë, mjafton të kujtohet rasti i gjykimit të Sokratit, kur akuzuesit Anitisi, Meletusi e Likoni ia arritën të manipulonin një bindje që ua turbulloi mendjen të pranishmëve aq shumë, sa ata votuan dënimin me vdekje të Sokratit, filozofit më të shquar dhe njërit ndër shtatë të diturit e lashtë të Greqisë. Akuzat ndaj Sokratit ishin mbështetur në shtrembërime, gjysmë të vërteta ose shpifje, mirëpo që të gjitha linin përshtypje si të ishin të vërteta të mirëfillta. Akuzuesit e Sokratit ishin retorë¹ të kohës ose që përdorën mjete retorike për

* *Hajdin Abazi, Dr i Filozofisë, ligjërues i rregullt në Universitetin AAB, hajdin.abazi@universitetiaab.com ose hajdinabazi2008@gmail.com*

¹ Fjala retor domethënë person që ushtron profesionalisht retorikën ose që paraqitet publikisht duke përdorur mjete retorike. Retorika është disiplina që merret me studimin teorik të së folmes, ose të ligjërimit publik. E në fjalorin elektronik të Henry George Liddell & Robert Scott. A Greek-English Lexicon,

të krijuar përshtypjen se thoshin të vërtetën dhe kështu fabrikuan bindje të manipuluar, e si pasojë e kësaj, Sokrati u dënua me vdekje, pa bërë asnjë krim.

Sokrati sikur e kishte parandjerë se e vërteta, po nuk u vu si qëllim të çdo njëri, mund të zvetënohet e shtrembërohet deri në masën sa të mos njihet fare. Që nga formimi i tij si filozof e deri në fundin e jetës së tij, Sokrati qe përpjekur të edukonte athinasit që për gjithçka e në gjithçka të prireshin nga e vërteta, si një masë që të mbrohen nga gabimet. Kjo përpjekje e tij sikur kulmon, në aspektin intelektual, me shqyrtimin kritik lidhur me retorikën, e cila kishte dëshmuar kapacitetin për të ndikuar në mendimet e qëndrimet e publikut, shqyrtim që zhvillohet midis Sokratit dhe mjeshtrit të retorikës Gorgiasit. Me këtë rast rishikohen bazat, karakteri dhe roli i retorikës, me pikësynim që të parashtrohej një qëndrim filozofik lidhur me të, për të vënë themele të qëndrueshme, të shëndosha, të mbështetura dhe dobisjellëse publike të retorikës.

Filozofia, qëndrimet dhe pikëpamjet e Sokratit janë portretizuar në shumë vepra të Platonit, si p.sh. tek *Apologjia e Sokratit, Kritoni, Meneksenoi, Eutydemoi, Faidroi, Sofisti* ku shprehen preokupimet e tij me aspekte të ndryshme të retorikës, kurse në veprën *Gorgiasit*, një dialog midis Sokratit dhe Gorgiasit me dishepujt Kalikleu dhe Poloi, parashtrohet disi e përmbledhur retorika në optikën e Sokratit.

Që nga lindja e saj si art apo si disiplinë dhe si profesion, pavarësisht kohëve, kushteve e rrethanave politike, megjithatë, objektivi i retorikës ka mbetur i njëjtë: të krijojë bindje me qëllim që të përfitojë besimin e audiencës domethënë të publikut. Pikërisht këtu, shfaqet një problem themelor, të cilin e pikasi

gjendet ky përkufizim "retori është folës (ligjërues) publik". Aristoteli jep këtë përkufizim: "një retor është ai, i cili shquan atë për të cilën mund të krijojë bindje në çdo situatë, pa përjashtuar asgjë", në *Topics*, 149b25.

Sokrati: Si duhet të arrihet bindja? Ku duhet të mbështetet ajo? Cili duhet të jetë karakteri, roli dhe mënyra e përdorimit të retorikës? Këto janë problemet kryesore, të cilat e kanë përcjellë retorikën që nga zanafilla e nuk janë vjetruar aspak as në ditët e sotme.

Retorët zakonisht pohojnë se qëllimi është “vetëm e drejta dhe e vërteta”, siç e shprehte edhe Gorgias në *Mbrojtja e Palamedit*², ashtu siç e thonë të tillët edhe sot e kësaj dite e gjithherë, kur shprehen ose komunikojnë me audiencën, respektivisht me publikun ose opinionin. Kështu, realisht, edhe duhej të ishte.

Por Sokrati, me mprehtësinë e tij prej filozofi, kishte shquar një praktikë tjetër të retorëve, dallimin midis aspektit deklarativ dhe veprimit për të krijuar bindje. Ai kishte shquar instrumentalizimin e retorikës për të arritur me çdo kusht qëllimin e caktuar të përdoruesit të saj, respektivisht për të manipuluar qëllimshëm publikun, në interes të ndonjë grupi apo individi të caktuar. Përdorimi i këtillë e shndërron retorikën në një veprimtari të dëmshme ndaj publikut, domethënë ndaj shtetasve e kështu edhe ndaj vetë shtetit. Për të kërkuar një perspektivë tjetër, më të mirëfilltë, Sokrati, në veprën e Platonit *Gorgias*, zhbiron me qasje kritike e shqyrtuese përtej të dukshmes, përtej të deklaruarës, duke synuar të penetrojë te thelbi i çështjes: të shquajë dukjen ose deklarimin nga ajo që është, respektivisht të shquajë aspektet formale të retorikës, t’i ndriçojë ato, të tregojë mundësinë e instrumentalizimit dhe dëmin që prodhon përdorimi i tillë i saj, si dhe të shtrojë një teori për një retorikë të mirëfilltë.

Prandaj dhe qëllimi i kësaj trajtесе është që, përmes qasjes krahasuese, duke sjellë mendimet argumentuese të të dy dijetarëve të mëdhenj, dhe interpretimit të tyre, të arrihet në përfundimin se retorika, që të jetë në shërbim të mirëfilltë të

² Gorgias. *Defence of Palamedes*, § 11.

publikut, duhet të jetë e mbrujtur me të vërtetën dhe se duhet të përdoret në mënyrë korrekte.

Nuk është vetëm retorika që krijon bindje

Në debatin midis Sokratit dhe Gorgiasit, objekt shqyrtimi bëhet çështja se çka krijon retorika³. Pohimin e Gorgiasit se retorika krijon të mirën më të madhe për njerëzit, Sokrati e hedh poshtë duke pohuar se mjeku, gjimnasti dhe biznesmeni, secili prej tyre pohon të njëjtën gjë⁴. Me këtë Sokrati tregon se ai pretendim është shumë i gjerë, e si i tillë i pavërtetë, gjë që kërkohet diçka më e përcaktuar dhe Gorgiasi si mjeshtër, postulon se retorika është "aftësi për të bindur me ligjërime"⁵. Në akordancë me këtë, Sokrati e saktëson: "retorika është prodhuese e bindjeve: kjo është e tëra me të cilën ajo ka të bëjë dhe ky është thelbi i detyrës së saj", duke e precizuar edhe më: ajo krijon bindje në shpirt⁶ domethënë në mendje. Afërsisht të njëjtën gjë e kishte pohuar edhe Gorgiasi se ligjërimi bindës ndikon në shpirt⁷, ku spikat thënia se "bindja, kur i përvijohet ligjërit, mund të impresionojë shpirtin si të dojë"⁸.

Se sa ndikim të madh ka bindja te individi, e rrjedhimisht edhe te publiku, e shpreh Gorgiasi te *Lavdërimi i Helenës*, ku flet se si ligjërimi bindës ia ka mashtruar shpirtin dhe e shtyn atë të bëjë veprimin, domethënë të lë burrin me kurorë dhe të shkojë me Parisin, i cili i dha shkas Agamemnonit të fillonte luftën shkatërrimtare kundër Trojës. Duke numëruar arsyet e ndikimit

³ Platon. *Gorgias*. F. 313, 451c.

⁴ Platon. Op. cit., f. 314-315, 451d-452c

⁵ Platon. Op.cit., f. 315, 452c

⁶ Platon. Op.cit., f. 315, 453a

⁷ Gorgias. *Encomium of Helen*. § 8-15.

⁸ Gorgias, *ibid.*, §13.

të bindjes, ndër të tjera, Gorgiasi thekson se “gara detyruese me fjalë, në të cilën një ligjërimit i thjeshtë, i shkruar me art por jo i thënë me të vërtetën, mund të magjepsë dhe të bindë një numër të madh [njerëzish]”⁹.

Është e vërtetë se retorika krijon bindje, por në këtë veprim ajo nuk është e vetmja, ashtu sikundër pretendonte Gorgiasi. Për ta sqaruar këtë, Sokrati e problematizon duke shtruar pyetjen: “A është retorika mjeshtëria e vetme që krijon bindje?”¹⁰. Dhe për të hedhur dritë mbi çështjen, merr shembull matematikanin, i cili për madhësi të ndryshme matematikore, prodhon bindje, të cilat kanë të bëjnë me serinë e shifrave tek dhe çift¹¹, gjë që çon te përfundimi: “Retorika, pra, nuk është e vetmja që prodhon bindje”¹².

Prej këndeje rrjedh nevoja që të përcaktohet edhe më nga afër se ç’lloj bindjesh prodhon retorika. Bazuar në shkrimet e Gorgiasit edhe nga veprat e përmendura të Platonit, retorika me ligjërimit bind para se gjithash dhe mbi të gjitha gjykatësit në procese gjyqësore, anëtarët e këshillit dhe anëtarët e kuvendit të popullit. Po aty pohohet se retorika është aftësia për të bindur çdo kuvend politik¹³, që domethënë se arrihet te përkufizimi se retorika krijon bindje politike.

Në këtë plan sqarohet edhe një çështje e rëndësishme: Sokrati përpiqet të shohë se cili është roli i ekspertëve të ndryshëm në krijimin e bindjeve. Ai përmend raste që në kuvendet e popullit për këshilla ftohen ekspertët e fushave të ndryshme, si për shembull kur duhen ngritur mure, bërë porte apo kantiere detare, atëherë aty ftoheshin mjeshtret e ndërtimit të tyre. A thua mos ishin këta ekspertë ata, të cilët kishin krijuar bindjen se ato

⁹ Gorgias, ibid.: §13.

¹⁰ Platon. *Gorgias*. F. 316, 453d

¹¹ Platoni. Op. cit., f.317, 453e-454a

¹² Platon. Op. cit., 317, 454a

¹³ Platon. Op. cit., 315, 452c

duhen bërë? Përgjigjen e jep Gorgiasi: “Te bindjet politike retorët nuk flasin për çështje ekspertësh, ata flasin për vetë çështjen”. Ai shprehet: “Muret e Athinës dhe ndërtimi i porteve u bënë me këshilla të Themistokliut dhe pjesërisht të Perikliut e aspak sipas këshillave të ekspertëve të ndërtimit”¹⁴. Sokrati, si filozof që pranon argumentet bindëse, pajtohet me këtë kundër argument se janë retorët ata që krijojnë bindje politike për të marrë vendime, e më pas, kur vjen çështja konkrete e realizimit të tyre, mund të ftohen ekspertët përkatës për këshilla profesionale.

Retorika luan rol aty ku ka pasiguri

Një çështje më vete është ajo se në ç’hapësirë, në ç’kushte e ç’rrethana, pra në ç’kontekst retorika mund të luajë rolin e vet, domethënë të prodhojë bindje. Nga shembulli i mësipërm lidhur me ngritjen e mureve të Athinës me dy qytetet e afërta, ka një nëntekst që tregon se kur mund të krijohen bindje te publiku, porse kjo nuk thuhet qartë.

Bindje mund të krijohen vetëm atëherë dhe në çështje kur ka pasiguri. Aty ku publiku nuk është i sigurt për diçka, aty mundet retori i zgjuar dhe i talentuar të krijojë bindje. Pyetjes së Sokratit se “Në cilën hapësirë mundet retori të thotë më së shumti?”, Faidros përgjigjet: “Natyrisht atje ku ne jemi të pasigurt”¹⁵. E për ta kuptuar këtë, retori duhet të shquajë kontekstet ku audiencia është e pasigurt e ku jo¹⁶ dhe, që ai të ketë sukses, përkatësisht që të krijojë bindje, duhet të përqëndrohet te konteksti ku ka pasiguri, sepse aty dhe vetëm aty ai ka për të thënë diçka nga vetja e vet.

¹⁴ Platon. Op. cit., f. 319-320, 455b-e. Është fjala për muret midis Athinës dhe Pireut dhe midis Athinës dhe Faleronit, të ngritur gjate viteve 461-456 p e r.

¹⁵ Platon. *Faidros*. F. 355, 263b

¹⁶ ibid.

E sipas koncepteve të Sokratit, aty ku dihet e vërteta nuk ka pasiguri, por pasiguri ka aty ku ka opinion, domethënë pikëpamje që nuk përputhen me realitetin ose me faktet.

Dallimi midis deklarativës dhe përmbajtësorës

Pas pajtimit për faktin se retorika krijon bindje, për Sokratin kjo nuk ishte e tëra, se ai donte të dinte edhe më. Për këtë Sokrati e pyet Gorgiasin: "Ç'loj bindjesh krijon retorika... bindje që gjeneron besim pa dije apo që gjeneron dije?"¹⁷. Shtrimi i këtillë i problemit prek thelbin e vetë çështjes që diskutohet. Gorgiasi jep një përgjigje kuptimplotë: "Ajo gjeneron besim"¹⁸. Me fjalë të tjera, retori nuk është prodhues i bindjeve që gjenerojnë dije, por që gjenerojnë besim, mundësi ose gjasa se diçka mund të jetë ashtu si duket apo siç parashtrohet, por duke mos prodhuar dije ose duke mos referuar në ndonjë dije – ajo mbetet ashtu e mjegullt përmbajtësisht dhe potencialisht e gabuar.

Sigurisht duhet kuptuar si çështje që shtron thelbin e jo ekskluzivitetin e njërës kundrejt tjetrës, për të nxjerrë në pah karakterin formal të retorikës siç praktikohet në të shumtën e herave në kuvendet e popullit asokohe. Nga shembulli i mësipërm i rolit të Themistokliut dhe Perikliut lidhur me muret mbrojtëse të Athinës, mund të konstatohet se shpesh besimi e dija shkrihen në një. Theksi vihet te shquarja, për shkak se ngatërrimi i tyre, që buronte nga rregullat formale por jo edhe përfillëse, rrezikon të prodhojë manipulim.

Sigurisht se, po të pyeteshin, askush nga ata që ushtronin retorikën nuk do të pohonin se besojnë hamendësimet e pambështetura dhe të pavërtetën. Këtë e pohon qartë Gorgiasi:

¹⁷ Platon. *Gorgias*. F., 319, 454e.

¹⁸ *ibid.*

“Duhet të besohet jo hamendësimi por e vërteta”¹⁹. E këtë e ripohon edhe gjetiu, më konkretisht akoma: “Rendi i duhur... për ligjërimin është e vërteta”²⁰. Me gjithë deklaratimet e tilla mbi atë se retorët duhej të mbështeteshin te e vërteta, sikurse e thotë Gorgias, në të shumtën e herave retorët krijonin bindje ose besime edhe kur përmbajtja e atyre “nuk kishte të bënte as një fjalë me të vërtetën”, siç u thotë Sokrati akuzuesve të tij në *Apologjinë*, gjë që shpreh se deri në ç’skallë besimi mund të duket i ngjashëm me të vërtetën, ndonëse është krejt i kundërt me të. Ky ishte një dallim thelbësor, sepse deklarativisht trumbetohej e vërteta si dekor, kurse përmbajtësisht kontrabandohej jo e vërteta.

Mekanizëm përshtypjekrijues

Nëse retorika është prodhuese e bindjeve që gjenerojnë besim të pambështetur në fakte të mirëfillta, atëherë rrjedh se ajo është thjeshtë një lloj mekanizmi, një lloj instrumenti, që ka kapacitet për të prodhuar bindje.

Pikërisht këtë lloj të retorikës e vë në thumb Sokrati kur thotë se retori “nuk ka nevojë të dijë se si janë gjërat në vetë realitetin”²¹. Kjo domethënë se retorika e Gorgiasit dhe e shkollës së tij, domethënë retorika formale, nuk merren me përmbajtjen e asaj që është shtruar si çështje në rend të ditës, përkatësisht me zbardhjen e të vërtetës, por me besime e hamendësime, ose me atë që duket si e vërtetë pa qenë e tillë.

¹⁹ Gorgias. *Defence of Palamedes*, §8

²⁰ Gorgias. *Encomium of Helen*, §1.

²¹ Platon. *Gorgias*. F., 324, 459b-c

Atëherë, si funksionon retorika? Sokrati ka një shpjegim: retorika ka gjetur "një mekanizëm për të prodhuar bindje"²². Me këtë mekanizëm retorët krijojnë përshtypje, respektivisht duke tjetër nga ç'është në të vërtetë. Kjo bëhet në dy aspekte. Njëri: me mekanizmin e krijimit të bindjeve para të paditurve, retori duket sikur di më shumë se sa ata që dinë²³; kurse tjetri: mësuesi, si p.sh. Gorgiasi, për retorët e rinj, nxënësit e tij, krijon përshtypjen [te ata vetë e te të tjerët] se ata dinë ato gjëra që në të vërtetë nuk i dinë²⁴.

Natyrisht se këtë nuk mund ta bëjë gjithkush. Pasi që për të krijuar përshtypje të tilla "kërkohet një aftësi për hamendësime të sakta dhe një shpirt guximtar, i cili për nga natyra është i zgjuar në raport me njerëzit"²⁵, e pikërisht kjo i kishte bërë të shquar dhe u kishte dhënë autoritet retorëve.

Sa i përket thelbit të retorikës formale, rrjedh se besimi të cilin e krijojnë bindjet që prodhojnë retorët, është një besim i pambështetur, në të vërtetë është vetëm një përshtypje që ata krijojnë.²⁶

Mjeshtri formale, pa ndonjë parim të njëmendtë

Sokrati nuk mjaftohet vetëm me konstatimin se retorika është një mekanizëm për krijimin e bindjeve, që të krijojë përshtypje te publiku, ai shkon më tej dhe dëshiron të zbulojë se përse është ajo e tillë. Në shërbim të kësaj, ai atë e krahason me gatimin. Gatimi pretendon të jetë i njëjlojtë me mjekësinë sa i përket shëndetit të trupit të njeriut, madje kuzhinieri do të bindte

²² ibid.324, 459c

²³ ibid.

²⁴ ibid., 325, 459e

²⁵ Ibid., f. 330, 463a

²⁶ ibid, 463b.

shumëkënd se e di më mirë se mjeku se çfarë i duhet shëndetit të njeriut²⁷, pasi që ai bën ushqime që ia pëlqen trupi i tij. Por, kjo është përshtypje e gabuar, duke krijuar bindjen se kuzhinieri ditka më shumë për shëndetin se sa mjeku, gjë që nuk qëndron. Kuzhinieri dhe retori ngjajnë për nga efektet që arrijnë: gatimi shkakton kënaqësi dhe qejf për trupin e njeriut, por ajo është thjeshtë një "përvojë praktike"²⁸, dhe e këtillë është edhe retorika: "përvojë praktike, rutinë"²⁹. Analogjia është kjo: sikurse kuzhinieri që ua përshtat ushqimin shijeve të personave të caktuar, ashtu edhe retori synon të prodhojë bindje për raste ose kontekste të caktuara, duke aluduar se ai nuk është i paanshëm.

Me këtë shembull Sokrati nxjerr në pah se retorikës i mungon diçka shumë serioze, i mungon një parim bazë, ndaj dhe në një gjendje të tillë, "gjithçka që nuk ka një parim të tillë nuk e quaj art"³⁰.

Në mungesë të një parimi të tillë, rrjedh se retorika krijon imazhe të pjesëshme të realitetit, konkretisht "krijon imazhe të një pjese të politikës"³¹, që domethënë se nuk depërton në thelbin e asaj që trajton e as tërësinë e saj, e që si e tillë nuk mund të jetë e plotë, dhe nuk mund të çojë te pohime të vërteta po vetëm te opinione³².

Nënkuptueshëm, ai shpreh një kritikë, gjithsesi të mbështetur të retorikës në gjendjen në të cilën ajo ishte, që bazohej thjeshtë vetëm në aftësi të caktuara, një retorikë formale. Si e tillë, duke lënë përshtypje se po përmbushte kriteret formale, retori mund të arrinte në përfundime që nuk preknin dot të vërtetën, duke u bërë mjet për manipulim, përkatësisht, sikurse e shpreh Sokrati,

²⁷ Ibid., f. 332, 464d-e

²⁸ ibid., f. 329-330, 462d-e

²⁹ ibid., f. 330, 463b

³⁰ ibid., f. 332-333, 465a.

³¹ ibid., f. 331, 463d,e

³² Ibid., f. 353, 262b

mekanizëm për të prodhuar bindje ose përshtypje, se gjërat janë ashtu por pa qenë substancialisht të tilla. Pikërisht për këtë shkak, Sokrati ia thotë Kalikleut, i cili si dishepull i del në mbrojtje mësuesit të tij Gorgiasit, se “një çast thua se diçka është ashtu, e çastin tjetër e njëjta gjë se është ndryshe”³³, duke nxjerrë në pah paqëndrueshmërinë e asaj që thotë, si shkak i mungesës së një parimi.

Kërkimi i një parimi rregullues

Qasja kritike i shërben Sokratit për të hetuar dobësitë, të metat dhe mangësitë që e kanë shoqëruar retorikën. Me kritikën e tij Sokrati e nxjerr në pah karakterin potencialisht manipulativ të saj. Pandaj, duke qenë se ushtrimi publik i retorikës ka një rëndësi të veçantë për shoqërinë, sidomos të ndikimit të saj të madh në politikë, kritika e tij shërben për të argumentuar paqëndrueshmërinë e saj, e pastaj të kalojë në ndërmarrjen tjetër: të përpiqet ta ndryshojë, ta përmirësojë atë dhe ta bëjë të tillë që të jetë në funksion dobiprurës për shoqërinë, përkatësisht shtetin, politikën.

Qëllimi kryesor i Sokratit është të gjejë e të formulojë qartë “një parim rregullues”³⁴, parim i cili i mungonte realisht retorikës, ndonëse ai pohohej në mënyrë deklarative. Një parim i këtillë rregullues, sipas koncepteve të Sokratit, ishte përcaktues për fushën me të cilën duhej të merrej një disiplinë ose një art, sikurse quhej zakonisht asokohe, pasi që kur “një rregull në çdo dukuri - rregullimi përkatës për çdo dukuri ekzistuese - bëhet, ajo e bën atë dukuri të mirë”³⁵. Dhe Sokrati vihet të gjejë e të

³³ Ibid., f. 386, 499c

³⁴ Ibid., f. 397, 506e

³⁵ ibid., f. 397, 506e

përcaktojë një parim të tillë rregullues, që duhet të vlejë për retorikën, që ajo të jetë sëpari në shërbim të mirë të shoqërisë.

Për dobishmëri të njëmendtë të retorikës

Retorika ka një kapacitet që të jetë e dobishme për publikun, me vetë faktin se ajo ka aftësi dhe mjetet e duhura për të krijuar bindje. Dobishmëria e saj mbetet e çastit ose koniunkturale, varësisht se si përdorej në interes të individëve ose grupeve të caktuara. Sokrati donte ta kthente atë në dobishmëri të qëndrueshme, përmbajtësore, të njëmendtë për publikun, ose të mirën e përgjithshme.

Idenë e tij të dobishmërisë së njëmendtë të retorikës, Sokrati e zhvillon në dy linja: kënaqësi - e mirë dhe e drejtë - e padrejtë.

Linja e parë: relacioni kënaqësi- e mirë. Polosi, dishepulli i Gorgiasit, e mbron pikëpamjen se retorika është diçka e bukur, meqë ajo njerëzve u sjell kënaqësi dhe qejf³⁶. Mirëpo, meqë sipas Sokratit “e mira nuk është e njëjtë si e kënaqëshmja”³⁷, atëherë jo çdo kënaqësi e qejf është i mirë. “E mira” sipas Sokratit, “quhet e mirë, sepse aty ka një prani të diçkaje të mirë në to”³⁸. Nga kjo mund të arrihet te përfundimi se një kënaqësi apo qejf është i dobishëm vetëm po qe se në to ka prani të së mirës dhe për aq sa ajo është e pranishme. E që retorika të jetë e bukur ajo duhet të përmbajë bukuri, e cila është e tillë vetëm kur në vetvete përmban dhe në përmasën që përmban të mirën e caktuar.

Linja e dytë, dobishmëria në relacionin e drejtë - e padrejtë. Për ta bërë oponentin, konkretisht Polosin, të kuptojë dobishmërinë e njëmendtë prej asaj surrogate, Sokrati tërheq

³⁶ *ibid.*, f. 329, 462c-d

³⁷ *ibid.*, f. 383, 497d

³⁸ *ibid.*, f. 383, 497e

paralelen midis të sëmurit me shëndet fizik dhe mental. Sëmundja e shëndetit fizik shpesh ndodh të shërohet me medikamente që nuk sjellin kënaqësi, por që e rikthejnë shëndetin. Me këtë Sokrati argumenton se në planin personal e dobishmja jo gjithherë është e njëjtë me kënaqësinë. E njëjta gjë ndodh edhe me shëndetin mental: kushdo që ka bërë ndonjë të padrejtë, ai është i sëmurë në shpirt. Nuk mund të jetë e dobishme diçka për të, që nuk sjell shërimin e tij shpirtëror. E ky shërim arrihet duke shpague për të padrejtën që ka bërë, domethënë duke vepruar me drejtësi³⁹ ndaj padrejtësisbërësit. E tërë kjo çon në konstatimin se retorika “nuk sjell asnjë dobi për ne... kur bëhet fjalë për të mbrojtur një të padrejtë kur ajo është bërë nga vetë ne, prindërit tanë, miqtë apo fëmijët ose nga atdheu ynë”⁴⁰. E jo sikundër konsiderohej asokohe që “retorika të jetë e dobishme” edhe në mbrojtjen e atyre që bëjnë të padrejtë dhe krime⁴¹, në kuptimin që edhe kur ata janë fajtorë përmes shfrytëzimit të retorikës të shpallen të pafajshëm. Sokrati hapur angazhohet për një retorikë në mbrojtje të së drejtës, si i vetmi veprim i dobishëm i mundshëm, meqë drejtësia sjell shërimin shpirtëror të individit por edhe të shoqërisë. “Të shpaguehet krimi është të çlirohesh nga e keqja më e madhe”⁴². E njëjta vlen dhe të evitohet bërja e krimit përmes gjykimit të padrejtë.

Me fjalë të tjera, që retorika të jetë njëmend e dobishme ajo duhet të shkaktojë ose të sjellë kënaqësi e qejfe që përmbajnë të mirën, si dhe të mbrojnë të drejtën, sepse kjo është kura për shëndetin mental, kura e shërimit të shpirtit për individin e për shoqërinë.

³⁹ *ibid.*, f. 354-357, 478a-479e

⁴⁰ *ibid.*, f. 358, 480b-c

⁴¹ *ibid.*, f. 359, 481a-b

⁴² *ibid.*, f. 355, 478d

Retorika duhet të mbështetet te e vërteta

Polosi, duke provuar ta bindë Sokratin, pohon se “shumë njerëz që kanë bërë të padrejtë janë të lumtur”⁴³. Sokrati nuk pajtohet dot me të, e Polosi i thotë: “Ti nuk do, por ti, gjithsesi, mendon ashtu siç po them unë”⁴⁴. Sokrati i kundërpërgjigjet: “Ti po provon të më mposhtësh me mjete retorike... Një mposhtje e tillë është pa ndonjë vlerë në çështjen e së vërtetës... unë nuk do të pajtohem me ty, edhe në qoftë se mbetem i vetëm, sepse nuk ke argumente detyruese...[kundër]... të vërtetës”⁴⁵.

Më pas, duke bashkëbiseduar me dishepullin tjetër të Gorgiasit, Kalikleun, kur i shqyrtojnë efektet e politikanëve të njohur, konkretisht të Perikliut, ndaj të cilit Sokrati drejton kritika të shumta, Kalikleu pyet nëse po i kërkonte të pajtohej me këto kritika, Sokrati i jep këtë përgjigje: “Në qoftë se mendon se po e them të vërtetën”⁴⁶.

Tërthorazi bëhet aludim te nevoja e themeleve të reja për retorikën, që e tërë veprimtaria e saj të jetë e përqëndruar në të vërtetën, meqë vetëm ashtu ajo mund të përmbushë misionin e vet dhe të jetë në shërbim të shtetasve dhe të shtetit, apo të publikut. Përndryshe, retorika mund të prodhojë efekte të kundërta. Më parë u theksua fakti se retorika formale nuk kapte tërësinë e asaj që shqyrtohej dhe nuk prekte thelbin, por krijonte vetëm imazhe, madje imazhe të pjesëshme⁴⁷. Si e tillë, ajo mund të arrijë efekte të caktuara, të krijojë bindje që çojnë në marrjen e ndonjë vendimi, i cili sipas gjasave do të jetë i gabuar dhe i padrejtë. Aftësia e retorëve mund të jetë e tillë që një të vërtetë të

⁴³ *ibid.*, f. 341, 470d

⁴⁴ *ibid.*, f. 343, 471e

⁴⁵ *ibid.*, f. 343, 471e-472a-c

⁴⁶ *ibid.*, f. 411, 516a-c

⁴⁷ *Ibid.*, f. 331, 463d,e

shtrembëruar ta paraqesin bindshëm si të vërtetë të mirëfilltë, gjë që ilustron aq bukur në fjalën hyrëse të Sokratit te *Apologjia* drejtuar bashkështetasve në fjalën e tij mbrojtëse: “Athinas!” – shprehet Sokrati, “Unë nuk e di se ç’përshtypje u kanë bërë juve akuzuesit e mi, por mua thuajse më bënë të harroja se cili jam, aq bindëse ishin ato që ata thanë”!⁴⁸

Në këtë kontekst lidhet edhe koncepti i Sokratit mbi bazamentin e ri të retorikës, të cilin ai po e kërkonte, të shprehura që në veprën e Platonit *Apologjia e Sokratit* e të formuluar qartë në veprën *Gorgias*. Ai shprehet qartë: një retor të shkathët e konsideronte vetëm atë “i cili e thotë të vërtetën”⁴⁹, dhe se në një kuptim të këtillë dhe vetëm të këtillë, ai do të pranonte të quhej retor, ndryshe jo.

Si duhet të jetë një retor

Retori i njëmendtë duhet të jetë ai që e thotë të vërtetën, sikundër e thotë Sokrati, sado që ajo mund të duket e hidhur në kohën kur shprehet, por duke qenë e vërtetë, ajo është më e mirë se imazhi ose opinionin i pavërtetë, me bindje e përshtypje të rreme.

Në veprën *Apologjia e Sokratit*, nga citati i mësipërm, theksohet se akuzat ndaj Sokratit ishin aq bindëse, sa thuajse edhe atë vetë e bindën se ishin të vërteta! E kjo nxjerr në pah fuqinë thuajse magjepsëse të retorikës për të ndikuar te të tjerët. Merreni me mend, sikur diçka kaq bindëse të ishte thënë për të vërtetën! Por ishte krejt e kundërta: “E megjithatë thuajse asgjë nga ajo që u tha [nga akuzuesit kundër Sokratit] nuk është e vërtetë”⁵⁰.

⁴⁸ Platon. *Sokrates försvartal*. F. 13, 17a

⁴⁹ *ibid.*, f. 13, 17b

⁵⁰ *ibid.*, f. 13, 17b

Akuzuesit, që shërbeheshin me mjetet retorike, “thua jse asnjë fjalë nuk e kishin shprehur që është e vërtetë”⁵¹ pohon Sokrati. E pra, si e kishin arritur ata një efekt të tillë, si kishin krijuar një përshtypje e bindje të pranishmit kundër Sokratit? Po aty Sokrati shprehet se ata kanë përdorur një gjuhë me lule, domethënë të zbukuruar me fjalë e fraza të bukura⁵², ndonëse e kishin shtrembëruar deri në shëmtim të vërtetën. Ndodhi ashtu sikurse e kishte argumentuar Gorgias: “një ligjërim i thjeshtë, i shkruar me art, por jo i thënë me të vërtetën, mund të magjepsë dhe të bindë një numër të madh njerëzish”⁵³, domethënë ishte manipuluar publiku me formulime që të dukeshin sikur ishin të vërteta, përkatësisht duke e instrumentalizuar retorikën.

Që të mos arrihen efekte të kundërta me të mirën e shtetasve dhe kundër të drejtës, Sokrati pohon se “është e domosdoshme që një retor të jetë i drejtë” dhe një i drejtë “është e domosdoshme të veprojë drejt”⁵⁴. Kështu, Sokrati thotë se retor i domosdoshmërisht duhet të jetë ndryshe nga ai që ishte asokohe i karakterizuar nga manipulimi dhe keqpërdorimi, të bëhej ashtu siç duhej të ishte: i drejtë dhe të vepronte me drejtësi. Si rrjedhojë, një retor i tillë “pra, kurrë nuk do të donte të vepronte jo drejt”⁵⁵.

Që dikush të jetë një retor i njëmendtë, sikurse pohon dishepulli i Gorgiasit, Polosi, duhet të ketë dije mbi të drejtën, të bukurën dhe të mirën⁵⁶. Pasi ka parashtruar pikëpamjet mbi të drejtën, drejtësinë dhe veprimin e drejtë si vlera kundrejt të padrejtës, padrejtësisë dhe veprimit të padrejtë, duke qenë se “e padrejta është e keqja më e madhe për atë që e bën atë” e e keqe edhe më e madhe është që “çdokush që ka bërë të padrejtë të

⁵¹ *ibid.*

⁵² *ibid.*, f. 13, 17c

⁵³ Gorgias, *Encomium of Helen*. §13.

⁵⁴ Platon. *Gorgias*. F. 326, 460c

⁵⁵ *ibid.*

⁵⁶ *ibid.*, f. 327, 461b

mbetet i padënuar”⁵⁷, duke aluduar se retorët bëjnë të keqen më të madhe kur vihen në shërbim të së padrejtës ose të pavërtetës, Sokrati shprehet shkoqur: “Ai që mendon të bëhet një retor i vërtetë, duhet vetë të jetë i drejtë dhe të ketë njohuri mbi atë se çka është e drejtë”⁵⁸.

Bazuar në parimin e të vërtetës dhe të së drejtës që Sokrati i parashtron si parime të retorikës, te *Apologjia e Sokratit* kishte theksuar decidivisht se “aftësia më e madhe e ligjëruesit është të thotë të vërtetën”⁵⁹. Me fjalë të tjera, kjo domethënë se një retor duhet konsideruar i aftë jo për mënyrën vetëm se si arrin të krijojë bindje te publiku për çështjen që u flet, por në përmasën që ai e thotë të vërtetën dhe mbi këtë bazë krijon bindje të drejta te publiku. Ky është një model i ri i retorit në optikën filozofike të Sokratit.

Retorika – t’i bëjë qytetarët më të mirë

Retori i njëmendtë mund të luajë një rol të rëndësishëm në shoqëri, gjë që e kishte hetuar Sokrati dhe përpiquej që të krijonte bazat e mirëfillta të retorikës, ashtu që i mbështetur në to, retor i të jetë jo koniunktural, por në mënyrë afatgjatë dhe të qëndrueshme i dobishëm ose të bëjë vepra të dobishme për shoqërinë.

Nga debati i zhvilluar midis Sokratit me Gorgiasin, Kalikleun dhe Polosin, arrihet te konstatimi se ka dy mënyra për të trajtuar çdo dukuri të veçantë, qoftë trupore ose shpirtërore: njëra është ajo që të angazhohesh për të krijuar kënaqësi, e tjetra synon më të mirën pa kërkuar kënaqësi, por bën fort përpjekje për më të

⁵⁷ *ibid.*, f. 400-401, 506b

⁵⁸ *ibid.*, f. 399-400, 508c

⁵⁹ Platon. *Sokrates försvarstal*. F. 14, 18a

mirën⁶⁰. Dhe duke qenë se përfitimi me të padrejtë (në kuptimin për të bërë pasuri, për të marrë pushtet, për të eliminuar oponentët) që disave u sjell kënaqësi, nuk ishte i qëndrueshëm dhe kishte efekte negative, madje ai nga Sokrati konsiderohet si krim, ose si sëmundje e shpirtit, duke arritur te përfundimi se ne “duhet t’i përkushtohemi shtetit dhe shtetasve në një mënyrë të tillë që t’i bëjmë vetë shtetasit të mirë sa të jetë e mundur”⁶¹.

Përmbyllje

Nga i tërë ky parashtrim mund të arrihet në përfundimin se Sokrati ka arritur të argumentojë mangësitë e të metat e retorikës formale të cilën e implementonte edhe Gorgias, e që i kishte të gjitha predispozitat të shndërrohej në manipulime, që ta lajthisë publikun për ndonjë interes të ngushtë, lidhur me çështjet që shtrohen e duhet gjykuar ose marrë vendim.

Sokrati ka treguar në mënyrë të mbështetur se mangësia kryesore është mungesa e një parimi rregullues ose një bazë të mirëfilltë të retorikës formale, e cila e pohonte një parim të tillë në mënyrë deklarative, kurse në praktikë veprohej ndryshe bazuar në raste, koniunktura apo sipas interesave të ngushta, e për pasojë, ajo instrumentalizohej, duke u përdorur si mekanizëm për të krijuar bindje të mbështetura në besim, në një kontekst ku publiku ka pasiguri në mungesë të të dhënave ose të njohjes të së vërtetës. Në një klimë të tillë, retorikë mund ta bëjë jo vetëm publikun, por edhe vetë personin të cilit i drejtohet gishti, që mos ta njohë veten e tij, ashtu sikundër deklarohet Sokrati për përshtypjen që i kishin lënë vetë atij akuzat e ngritura. Rasti i akuzës ndaj Sokratit është drastik, tipik për të treguar

⁶⁰ Platon. *Gorgias*. F. 406-407, 513d

⁶¹ *ibid.*, f. 407, 513e

manipulimin ose mundësinë e instrumentalizimit të retorikës dhe të mjeteve të saja.

Sjelljen e këtillë Sokrati e shpreh kur pohon se retorikë “i trajton kuvendet e popullit” domethënë audiencën, publikun, opinionin, “si fëmijë dhe vetëm përpiqet t’i kënaqë ata pa e çarë kokën nëse ashtu ata bëhen më të mirë apo më të këqinj”⁶². Efekti i kënaqësisë arrihet duke ligjruar ashtu siç duan ata që një retorikë të flasë, e jo siç është e vërteta dhe e drejta, të cilën shpesh mund të mos e duan, sidomos ata që mund të preken ose çënohen nga ajo. Një retorikë i tillë është i papërgjegjshëm, sepse ai nuk kujdeset që shtetasit të bëhen më të mirë, madje ai nuk merakoset nëse ata bëhen edhe më të këqinj, sepse ai ka një pikësynim: të arrijë atë në shërbim të të cilit (individ apo grup të interesit) është, pavarësisht pasojave të mundshme.

Kështu, kritika e Sokratit ndaj retorikës formale të kohës së tij, e vënë në dialog me Gorgiasin dhe dishepujt e tij Kalikleun dhe Polosin, ka argumentuar në mënyrë të mbështetur të metat e saj, të cilën, si të tillë, e bëjnë manipuluese dhe instrumentalizuese. Kritika e Sokratit kishte për qëllim përmirësimin, respektivisht kërkimin e bazave të qëndrueshme, që ta shndërrojë retorikën në një disiplinë për çka ajo kishte kapacitet dhe të bëjë e dobishme jo dosido dhe vetëm për individin apo koniunkturën, por për të vërtetën, të drejtën dhe të mirën në përgjithësi, të publikut.

Për ta bërë të tillë retorikën, Sokrati e ristrukturon atë, duke i vënë themele të reja, të cilat shuanin diskrepancën midis deklaramentit dhe veprimit, por e bënin koherent deklaramentimin me veprimin, teorinë me praktikën. Parimi bazë dhe rregullues duhet të jetë e vërteta, dhe si e tillë e vërteta gjithëherë është e drejtë, dhe si në teori edhe në praktikë këto dy parime duhej të kombinoheshin, ashtu që të jepnin rezultatin e duhur.

⁶² *ibid.*, f. 392, 502e-503a

Retorët që udhëhiqen nga parime të tilla të retorikës, domethënë të mbryjtur me të vërtetën dhe të drejtën, “kujdesen që shpirtrat e shtetasve të bëhen sa më të mirë të jetë e mundur dhe fuqishëm duan t’ua thonë atë që është më e mira, pavarësisht se a e kënaq apo jo audiencën”⁶³.

Dhe në fund, mund të thuhet se filozofia e Sokratit mbi retorikën, si mjet i institucionit të komunikimit publik, ndonëse e shtruar njëzet e katër-pesë shekuj më parë, është një ideal, i cili mbetet sfidë, për të treguar se sa e shëndoshë është një shoqëri, jo në dukje, por në përmbajtje. Ajo ka kaq shekuj që na flet, na shfaqet, po ne shtiremi sikur nuk e dëgjojmë, nuk e shohim, pavarësisht se shoqëria në kohën e globalizimit ka më shumë se asnjëherë më parë nevojë për një komunikim publik të mbështetur në të vërtetën dhe të drejtën.

Bibliografia:

Aristotle. *Topics*. Në “Complete Works”, përkthim i reviduar i Oxfordit, edituar nga Jonathan Barnes, Princeton University Press, Princeton, N.J. 1991.

Gorgias. *Encomium of Helen*. Në <http://www.classics.ucsb.edu/classes/cla175-s09/Gorgias.pdf>, parë për herë të fundit më 26 prill 2016.

Gorgias. *The defence of Palamedes*. Në: <http://www.humanistictexts.org/gorgias.htm>, parë për herë të fundit më 26 prill 2016

Platon. *Gorgias*. Në “Skripter”. Bok 1. Përkthyer në suedisht nga Jan Stolpe, Atlantis, Stockholm, 2000.

Platon. *Sokrates försvarstal*. Në “Skripter”. Bok 1. Përkthyer në suedisht nga Jan Stolpe, Atlantis, Stockholm, 2000.

⁶³ *ibid.*, f. 392, 503a-b

Platon. *Faidros*. Në "Skrifter". Bok 2. Përkthyer në suedisht nga Jan Stolpe, Atlantis, Stockholm, 2001.

Henry George Liddell & Robert Scott. *A Greek-English Lexicon*, në

<http://www.perseus.tufts.edu/hopper/text?doc=Perseus%3Atext%3A1999.04.0057%3Aentry%3D%2392385&redirect=true>,
pare për here të fundit 20 prill 2016, ora 15.19